



Data: 29/07/2019

Ref.: 1361/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji Heimerer në nivel institucional, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022
- II. Riakreditohen programet e studimit:
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2024, me nga 200 studentë për vit akademik.
 - Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc, 120 ECTS për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 50 studentë për vit akademik.
 - Psikologji Vlerësimi dhe Intervenimi, MA Profesional, 120 ECTS për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 40 studentë për vit akademik.
- III. Obligohet Kolegji Heimerer që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy etimi

- I. Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Heimerer më datë 16.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Melita Kovačević, Prof. Dr. Danica Železnik, Prof. Dr. Helvi Kyngäs.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Heimerer dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Kolegji Heimerer përmbush në mënyrë substanciale standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, prandaj rekomandon riakreditimin e këtij institucioni.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Heimerer
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë